



Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK) është organizatë joqeveritare që angazhohet për krijimin e një mjedisi më të zhvilluar socio-ekonomik në zonat rurale duke mbështetur aktivitetet bujqësore, ri-integrimin e njerëzve të kthyer, zbutjen e varfërisë, zvogëlimin e importit, promovimin e praktikave të mira bujqësore, zvogëlimin e papunësisë duke përfshirë të gjitha grupet shoqërore pa dallim feje, etniteti apo gjinie

IADK ka filluar të zbatojë projektin *"Përfshirja ekonomike e të kthyerve përmes bujqësisë në zonat rurale dhe ngritja e kapaciteteve përmes formimit profesional"*, financuar nga donatori Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), ku objektivi i përgjithshëm është rritja e gjenerimit të të ardhurave dhe edukimi i të kthyerve dhe familjeve në zonat rurale. Projekti do të trajtojë shkallën e papunësisë, duke synuar të kthyerit, gratë, minoritetet dhe personat me aftësi të kufizuara.

IADK kërkon kandidat të kualifikuar për pozitën:

Titulli i vendit të punës: **Inxhinier i Bujqësisë, Prodhimtari bimore, Lavërtari**

Vendi i punës: **Sfaraçak i Ulët nr. 11, 42 000 Vushtrri**

Kohëzgjatja: **15.04 - 31.12.2019**

Përshkrimi i punës:

Inxhinier i Bujqësisë do të jetë përgjegjës për zbatimin e objektivave të projektit dhe kordinimin e punëve në baza ditore.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të ofroj trajnime për fermerët përfitues të organizatës në fushën e perimeve në serra dhe fushë të hapur;
- Të ofroj trajnime për fermerët përfitues të organizatës në fushën e lavërtarisë;
- Të kontribuoj në zbatimin e projekteve të IADK-së në komunat e synuara;
- Të identifikojë kërkesat e fermerëve për grante të ndryshme, paketa investuese me qëllim punësimi dhe gjenerimi të të ardhurave;
- Të ndihmoj në punët me palë - fermerë në sektorin e bujqësisë, në veqanti perime;
- Të ndihmoj në pranimin e dokumenteve-aplikacioneve të fermerëve;
- Të organizoj dhe marr pjesë në vizitat fermerëve direkt në ferma;
- Të konsultoj dhe ofroj këshilla për fermerët për sektorin e perimeve dhe lavërtarisë;
- Të ndihmoj në futjen e të dhënave për fermerë aplikues në data bazë;
- Të monitoroj dhe përcjell fermerët për zbatimin e këshillave të ofruar, të plotësoj dokumentacionet e kërkuar si: të monitorimit dhe raportimit;
- Të organizoj dhe të marr pjesë në vizitat lokale, regjionale dhe më gjerë së bashku me fermerët për shkëmbimin e përvojave;
- Të kryej edhe punë tjera që do të kërkojnë nga Drejtori Ekzekutiv i IADK-së.

Kualifikimet dhe kompetencat kryesore:

- Diplomë universitare, Fakulteti i Bujqësisë, drejtimi perimekulturë ose e ngjashme
- Së paku 2 vite përvojë pune praktike në fushën e perimeve dhe lavërtarisë
- Njohuri praktike në punën në teren dhe punën me fermerë
- Aftësi të mira komunikimi
- Aftësi për punë në ambient multietnik
- Aftësi për tu përshtatur në punën ekipore
- Aftësi për punë me qetësi nën presion të kohës
- Shkathësi kompjuterike: Word, Excel dhe Power Point
- Të flet dhe të shkruaj mirë gjuhët: Shqip, Anglisht dhe Serbisht (e preferuar)
- Të posedojë patentë shofer valid, kategoria B
- Të jetë i/e gatshëm (e) për udhëtime brenda dhe jashtë Kosovës



Të interesuarit mund të aplikojnë duke dërguar CV-në dhe një letër motivuese direkt në zyrat e IADK-së Sferaçak i Ulët nr.11 Vushtrri, ose përmes emailit prokurimi@iadc.org

Dorëzimi i aplikacioneve mund të bëhet deri më 10.04.2019.

Personi kontaktues: Ariana Selmani Peci - Zyrtare për Prokurim&Administratë, tel. 049 777 059

Pjesëtarët e minoriteteve dhe femrat inkurajohen të konkurojnë. Vetëm kandidatët nga lista e ngushtë do të ftohen në intervistë.